



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Nr/Br.

atë/Datum.

864/19
27.12.19

PRISHTINE - PRISTINA

PSH .nr. 864/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “Besim A.Zejnullahu B.I- N.SH.EKO-DDD”-Ferizaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik: “Vlera” Shpk & “Eko Dez Doo”- Shtime, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institacioneve arsimore” me nr. të prok:616-19-1655-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Prishtinës, më datën: 18.12.2019, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Besim A.Zejnullahu B.I- N.SH.EKO-DDD”-Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institacioneve arsimore” me nr. të prok:616-19-1655-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Prishtinës.

II.ANULOEHT, njoftimi për dhënien të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institacioneve arsimore” me nr. të prok:616-19-1655-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Prishtinës dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik “Besim A.Zejnullahu B.I- N.SH.EKO-DDD”-Ferizaj, aprovohet pjesërisht si e bazuar , i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “Besim A.Zejnullahu B.I- N.SH.EKO-DDD”-Ferizaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 02.12.2019 me nr. 864/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore” me nr. të prok:616-19-1655-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Prishtinës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1,7, 28, 56.3, 59, 69, 72 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtares i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 03.12.2019, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 10.12.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim: Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 7, 56.3, 59, 69 dhe 72,të LPP-së. Eksperti shqyrtares sqaron, se bazuar ne vendimeve te nxjerr nga OSHP Nr. 315/19 te datës 08.10.2019,Nr. 523/19 te datës 07.11.2019 si dhe kjo lëndë /aktivitet i prokurimit është hera e trete qe po e shqyrtoje dhe për pretendimet te cilat janë shqyrtuar me parë dhe janë trajtuar, konsiderojeni çështje te gjykuara “Resjudikata”, andaj nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtares. Eksperti shqyrtares sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit (ne këtë aktivitet te prokurimit), AK - ZPP ka, ekzaminuar dhe krahasuar, ofertën e OE ankues pjesëmarrës në këtë aktivitet të

prokurimit, mirëpo lidhur me këtë lende, ne te cilën ne vendimin e nxjerr nga ZPP - ne kërkesën për rishqyrtim te operatorit ekonomik ankues, të datës 26.11.2019, i 'ja përkujtoj autoriteti kontraktues, Zyrtarit Përgjegjës te Prokurimit, si në vijim: "Është kompetence dhe përgjegjësi e plote e autoritetit kontraktues, respektivisht e komisionit të vlerësimit/ri-vlerësimit, që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve me kusht që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin të bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës, sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, duke marr parasysh Aneksin 1 në dosje të tenderit", duke i pasur parasysh te këto sqarime si me lart dhe 2 (dy) vendimet e OSHP-së tenxjerra lidhur me këtë lëndë, gjithashtu i 'ja rikujtoj ZPP se përgjegjësia mbi shpërblimin apo dhënien e kontratës bie mbi AK – ZPP dhe jo mbi ndonjë individ apo institucion tjetër.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 108/Atë LPP-së. Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës, autoriteti kontraktues pas vendimit te fundit te OSHP nr. 523/19 te datës 07.11.2019, që ky aktiviteti i prokurimit te kthehet ne Ri-vlerësim, AK nuk ka ngarkuar në platformën elektronike raportin e komisionit te vlerësimit, por me date 19.11.2019, ka publikuar - B58 njoftimin mbi vendimin e AK, pas këtij njoftimi OE ankues përmes platformës elektronike ngrite kërkesën për rishqyrtim pran AK te datës 22.11.2019, ndërsa AK nxjerr vendimin mbi refuzimin e kërkesë për rishqyrtim, lidhur me këtë aktivitetit te prokurimi me date 26.11.2019, mirëpo bazuar ne vendimi e nxjerr nga ZPP te datës 26.11.2019, tek pjesa e ARSYTIMIT ne këtë vendim, po citoj: "Pretendimet e parashtruesit te kërkesës lidhur me te gjitha mangësitë e tenderit te kandidatit te propozuar për dhënie te kontratës mund te jenë te bazuara për ne si Autoritet Kontraktues, por jo edhe për OSHP-në, qe është organ për shqyrtim te ankesave. Ua përkujtojmë se shumicën prej mangësive qe ju i keni cekur ne kërkesën tuaj si mangësi qe bëjnë tenderin e te njëjtit te papërgjegjshëm i kemi konstatuar ne vlerësimit paraprake, por te gjitha janë refuzuara nga Vendimet e OSHP-se. E vërteta është se OSHP-ja, e ka kthyer aktivitetin ne rivlerësim, por i ka pranuar pretendimet e ankuesit dhe i ka konsideruar si te pa ligjshme rekomandimet tona qe ju te jeni fitues i kontratës, prandaj këtë here është vendosur sipas rekomandimeve te OSHP-se". AK kur ka nxjerr vendimin në fjalë, nuk ka respektuar nenin 108/A par. 8.4 të LPP-së, po citoj: "autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi" si dhe nenin 108/A par. 9 të LPP-së, po citoj: "Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë", duke u bazuar ne këto fakte AK – ZPP, ka qenë i obliguar ne vendimin e nxjerre tek pjesa e arsyetimit, ta arsyetoj B58 Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues – (njoftimin për dhënien te kontratës), përmes bazës ligjore te LPP-se, lidhur me pretendimet e OE, mirëpo

një gjë te tille AK nuk e ka bere, po ashtu duke pas parasysh se përgjegjësin mbi ekzaminimin, vlerësimi dhe krahasimin e tenderëve është e drejtë ekskluzive e autoriteti kontraktues – komisionit te vlerësimit – zyrtarit përgjegjës te prokurimit ne pajtim ne nenin 59 te LPP-se, gjithashtu i ‘ja rikujtoj ZPP se përgjegjësia mbi shpërblimin apo dhënien e kontratës bie vetëm mbi autoritetin kontraktues – Zyrtarin Përgjegjës te Prokurimit. Prandaj, në bazë të analizës se dokumentacionit te prezantuar, pretendimet e palës në ankesë në këtë pikë janë pjesërisht të qëndrueshme.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe rekomandon që të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 10.12.2019 , me anë të shkresës zyrtare është njoftuar nga OSHP-në lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues, mirëpo te njëjtit nuk kane kthyer përgjigje.

Operatori Ekonomik, me datë: 11.12.2019 , me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 18.12.2019, ku kanë qenë prezent të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesi i OE-së ankues, përfaqësuesit e AK-së, ndërsa eksperti shqyrtues mungon i njëjti ka njoftuar me ane të parashtresës me arsyetimin e mungesës se tij dhe njëkohësisht deklaron se mbetet mbrapa raportit te dhënë ne ekspertize, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Sylejmani deklaroj: Keq qe nuk është Eksperti Shqyrtues sepse kemi te beje drejt për se drejti me një çështje profesionale qe ne tërsi është profesionale, ne kemi kundërshtuar raportin e tij ashtu siç parasheh LPP dhe kemi pas dëshirë te ballafaqohemi me te sepse një ekspertize është jo profesionale dhe ka te bëjë ne shkeljet e OE te cilën e përfaqësoj, shkeljet janë Evidente nga AK dhe Eksperti Shqyrtues. Është bërë në ketë aktivitet te prokurimit gjuajtja e topit here në OSHP e here në Autoriteti Kontraktues, eksperti shqyrtues e konfirmon

një shkelje te Autoriteti Kontraktues i cili ka qenë i detyruar te bëjë Ekzaminimin vlerësimin e tenderëve sepse nga dispozitat e nenit 115.6 edhe kur lënda kur kthehet ne rivlerësim nuk nënkupton se Autoriteti Kontraktues nuk ka te drejt ta shpërblej OE-ne e shpallur edhe me herët por duhet te kryej veprimet sipas ligjit. Ne kemi te bëjmë me një OE te rekomanduar i cili asnjë kërkesë te DT- dhe specifikave ketë e ka pas edhe Autoriteti Kontraktues është dashur Eksperti Shqyrtyes profesional ti konfirmoj edhe herën e par edhe tash.

Është kërkuar Epidiomilok dhe teknik sanitar në DT si dëshmi është kërkuar Diplome CV kontrate dhe Licence Valide për pune, i njëjtë Certifikate të epidimologut ka, CV i mungon që është e detyrueshme sipas MSH në UA Regjistrimi i profesionisteve shëndetësor sipas nenit 2 dhe 8 qe obligohen qe veprimtarin ta ushtrojnë pas Licencimit, sikur se Avokatet, e njëjta është e dhe tek Tekniku sanitar i mungon Licenca VC, Kontrata.

Pika tjeter asnjë pajisje e ofruar nuk korrespondon me kërkesë ne DT-së- ne kemi te bëjmë me një AP qe ka te bëjë me DDD te hapësirave te brendshme jo te jashtë qe ofron pajisje 166 KG peshe dhe specifikat teknike te këtyre pajisjeve sipas prodhuesit janë përmontim ne automjete. Te gjithë tenderët i ka fituar me këto letra, asnjë pajisje nuk e ka konform DT-se.

Kemi te bëjmë me produkte te ofruara ju lutem ne DT dhe specifikkime teknike është kërkuar për se cilin produkt te ofruar, Certifikate te atestit për deratizim asnjë certifikate nuk e ka përketë kam dashtë te pyes ekspertin e ka apo nuk e ka, si për Deratizim, Dezinsektim deratizim, kemi te bëjmë me një OE qe është ne konsodrcium qe është me një OE nga Serbia, ne kemi pas dyshime edhe me herët ne seanca tjera e qe janë konfirmuar me vonë me QS, tani ka edhe dikë tjeter ne DT ne ofertën e tij është dorëzuar vërtetimi se i njëjti nuk është i dënuar apo zhvillohet ndonjë procedurë penale apo eshë ne falimentim, i njëjti ka ofertuar ne ministrin e punës sociale dhe është aprovuar ankesa e tij dhe tani është rekomanduar nga Ministria, kjo është ajo qe ka ofruar përketë AP janë 2 shifra identike për vërtetim te ndryshme me data te ndryshme, ne tani i kemi zbuluar rastësish duke bërë krahasimet e ofertave. Pasi kemi gjete ketë ju kemi drejtuar Agjencisë qe ka lëshuar ketë vërtetim një agjension e ka edhe një dege ne Kosove drejtpërdrejt arkivues dhe personave sipas kontakteve” A ka mundësi te nderohet nr XXX/19 nëse jepet ne data te ndryshme” edhe përgjigjen e kemi marre Çdo vërtetim ne rastin e lëshimit e merr nr e ndryshëm, gjithashtu edhe tek Certifikata kemi pyetur a është kompetente Gjykata apo agjensioni për lëshimin e këtyre Certifikatave, Vërtetimi te cilin e lëshon Gjykata Ekonomike konstaton se a është e shqiptuar masa e ndaljes apo është filluar procedura e likuidimit ndërsa vërtetimi qe Agjencia e lëshon

konstaton se a është ndonjë mas ne regjistruar ne regjistrin e organit kompetent, Avokati i ankuesit Panelit i dorëzon dëshmitë 2 Vërtetime te lëshuara nga Agjencia për regjistrime te Serbisë me nr te njet BD 75552/2019 me përbajtje te njëjtë, njëra është lëshuar me date 06.08.2019 ndërsa tjetra është lëshuar me date 04.10.2019. si dhe ka dorëzuar njoftimin te cilin e ka lëshuar Agjencia për regjistrimin Ekonomik te Serbisë ne te cilin është sqaruar se vërtetimet duhet te kenë numra te ndryshme.

Këtu ka shume gjera unë personalisht kam kontaktuar me pronarin Kompanisë me Z. Voisllav Majstorovic për te sqaruar këto dokumente te cilat janë drejtpërdrejt te lëshuar nga ajo kompani qe ka marr ajo për të aplikuar në ketë DT dhe qe e implikojnë drejtpërdrejt atë me është përgjigjur asnjë here nuk kam marr pjese ne tender për pos një tenderi ne Mitrovice te Veriut te cilat ia kam dhëne OE Vlera sepse e kam klient timin dhe furnizohet me material produkte qe kemi ne për Kosove, lidhur me dokumente asnjë here nuk kam nënshkruar ne asnjë dokument sikur qe është ky i pajisjes për shembull i nënshkruar dhe i vulosur nga OE EKO DEZ dhe përgjigja e tij ka thëne nuk ka logjik te nënshkruar në një gjuhe te cilën nuk e njoh dhe dokumente tjera ne asnjë dokument , kam kërkuar përgjigje dhe me ka thëne te lutem me kurse sepse një parashtrese e imja do ti shkaktonte pasoja mikut tim". Avokati i dorëzon panelit shqyrties dëshmitë Deklaratën për pajisjet nga data 23.04.2019 për të cilat pretendon se edhe falsifikuar.

Gjatë prezantimit në seancë deklaratën e vazhdoj përfaqësuesi tjetër i OE z. Zejnnullahu: ne blejmë produkte nga EKO DEZ dokumente qe ai i ofron mundeni te keni qasje ne vulën e tij vula qe është ne fature dhe ne certifikate te tjera mundesh ti qen ne cilin do dokument ketë e kemi vërtetuar, ne mënojmë qe te njëjtë gjë e ka bre edhe tek Ministria e Punës por për një shkak te një problemi familjar qe kemi pasur nuk kemi mundur te anko hemi dhe na ka kaluar afati. Pastaj kam hulumtua ne E-prokurim emaili edhe është ne prokurim është ndryshe ne atë te EKO DEZ, gjuhen serbe nuk e njoh por kemi angazhuar një person dhe i ka konfirmuar te njëjtat qe avokati i tha ne ketë seance.

Avokati i OE-se deklaroj: E-maili www.eko.dez.info Drejtori Voisllav Majstoreviqi adresa e tij elektronike është voja@des.info. Adresat kontaktuese nuk nga keto :Hotmail. Gmail etj.

Ne kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues te veproj konform nenit 99.2 te LPP-së pasi ka prova te mjaftueshme për te bërë kërkese.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj. Sekiraqa deklaroj: Autoriteti Kontraktues KK-PRISHTINE qëndron prapa 2 vlerësimeve te para te këtij AP ketë e ka cekur edhe ne raportin e fundit te vlerësimit edhe e konsideron se OE ne konsorcium Vlera dhe EKO DEZ nuk janë OE- te përgjegjshëm, nuk i kanë plotësuar kërkesa e DT-s, as pas kërkese me letër standarde, por komisioni ka rekomanduar

prapë se prapë dhënien e kontratës për ata OE duke u bazuar ne vendimin e fundit të OSHP-se , vendimi i fundit i OSHP-së nuk ka qenë urdhërese por te gjitha sugjerimet kanë quar ne atë se duhet te respektohet vendimi i tij se OE Vlera dhe Eko Dez te jene te përgjegjshëm.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Sylejmani deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues te aprovon ankesën tone si te bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj. Sekiraqa deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues qe ankesa te aprovohet si e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie te kontratës.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 7, 56.3, 59, 69 dhe 72, të LPP-së. paneli shqyrtues konform konstatimit te Ekspertit shqyrtues profesional sqaron, se bazuar ne vendimet e nxjerra nga OSHP Nr. 315/19 te datës 08.10.2019, PSH Nr. 523/19 të datës 07.11.2019, shihet se kjo lëndë /aktivitet i prokurimit është hera e trete qe shqyrtohet dhe për pretendimet te cilat janë shqyrtuar me parë dhe janë trajtuar, konsiderojmë çështje te gjykuara “Resjudikata”,

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit (ne këtë aktivitet te prokurimit), AK - ZPP ka, ekzaminuar dhe krahasuar, ofertën e OE ankues pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, mirëpo lidhur me këtë lende, ne te cilën ne vendimin e nxjerr nga ZPP - ne kërkesën për rishqyrtim te operatorit ekonomik ankues, të datës 26.11.2019, i ‘ja përkujtoj autoriteti kontraktues, Zyrtarit Përgjegjës te Prokurimit, si në vijim: “Është kompetence dhe përgjegjësi e plotë e autoritetit kontraktues, respektivisht e komisionit të vlerësimit/ri-vlerësimit, që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve me kusht që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin të bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës, sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, duke marr parasysh Aneksin 1 në dosje të tenderit”, duke i pasur parasysh te këto sqarime si me lart dhe 2 (dy) vendimet e OSHP-së te

nxjerra lidhur me këtë lëndë, gjithashtu i ‘ja rikujtoj ZPP se përgjegjësia mbi shpërblimin apo dhënien e kontratës bie mbi AK – ZPP dhe jo mbi ndonjë individ apo institucion tjetër.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 108/Atë LPP-së. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës, autoriteti kontraktues pas vendimit te fundit te OSHP nr. 523/19 te datës 07.11.2019, që ky aktiviteti i prokurimit të kthehet ne Ri-vlerësim, AK nuk ka ngarkuar në platformën elektronike raportin e komisionit të vlerësimit, por me date 19.11.2019, ka publikuar - B58 njoftimin mbi vendimin e AK, pas këtij njoftimi OE ankues përmes platformës elektronike ngrite kërkesën për rishqyrtim pran AK te datës 22.11.2019, ndërsa AK nxjerr vendimin mbi refuzimin e kërkesë për rishqyrtim, lidhur me këtë aktivitetit te prokurimi me date 26.11.2019, mirëpo bazuar ne vendimi e nxjerr nga ZPP të datës 26.11.2019, tek pjesa e ARSYTIMIT në këtë vendim, thuhet: “Pretendimet e parashtruesit te kërkesës lidhur me te gjitha mangësitë e tenderit te kandidatit te propozuar për dhënie te kontratës mund te jenë të bazuara për në si Autoritet Kontraktues, por jo edhe për OSHP-në, qe është organ për shqyrtim te ankesave. Ua përkujtojmë se shumicën prej mangësive që ju i keni cekur ne kërkesën tuaj si mangësi që bëjnë tenderin e të njëjtit t papërgjegjshëm i kemi konstatuar ne vlerësimit paraprake, por te gjitha janë refuzuara nga Vendimet e OSHP-se. E vërteta është se OSHP-ja, e ka kthyer aktivitetin ne rivlerësim, por i ka pranuar pretendimet e ankuesit dhe i ka konsideruar si te pa ligjshme rekomandimet tona qe ju te jeni fitues i kontratës, prandaj këtë here është vendosur sipas rekomandimeve te OSHP-se”. AK kur ka nxjerr vendimin në fjalë, nuk ka respektuar nenin 108/A par. 8.4 të LPP-së, citat: “autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi” si dhe nenin 108/A par. 9 të LPP-së, po citoj: “Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë”, duke u bazuar në këto fakte AK - ZPP, ka qenë i obliguar në vendimin e nxjerr tek pjesa e arsyetimit, ta arsyetoj B58 Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues - (njoftimin për dhënien te kontratës), përmes bazës ligjore të LPP-së, lidhur me pretendimet e OE, mirëpo një gjë te tille AK nuk e ka bërë, po ashtu duke pas parasysh se përgjegjësin mbi ekzaminimin, vlerësimi dhe krahasimin e tenderëve është e drejte ekskluzive e autoriteti kontraktues - komisionit të vlerësimit – zyrtarit përgjegjës të prokurimit ne pajtim në nenin 59 të LPP-se, gjithashtu i ja rikujtojmë ZPP së përgjegjësia mbi shpërblimin apo dhënien e kontratës bie vetëm mbi autoritetin kontraktues – Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit. Prandaj, në bazë të analizës se dokumentacionit të prezantuar, pretendimet e palës në ankesë në këtë pikë janë pjesërisht të qëndrueshme.

Paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit autoriteti kontraktues duhet të analizoj pretendimet e operatorit ekonomik ku ne seancën për shqyrtim kryesor përfaqësuesi OE z. Zejnullahu, i cili kërkojnë nga Autoriteti Kontraktues te veproj konform nenit 99.2 të LPP-së pasi qe sipas tij ka prova te mjaftueshme për te bërë kërkese.

Andaj paneli shqyrtues konstaton se AK me rastin e rivlerësimit duhet te vërtetoj pretendimet e OE te cekura si me lart dhe te vërteton se cili do nga OE -të pjesëmarrës ne aktivitetin e prokurimit qe ka ofertuar me dokumente të falsifikuara apo te rreme, AK në pajtim me nenin 99 të LPP-së është e obliguar që të vazhdoj procedurat me kërkese për te kërkuar nga OSHP marrjen e masave për cilindo nga këta ofertues që ka ofertuar me dokumente te falsifikuara apo të rreme.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkësëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Komuna e Prishtinës
- 1x1 OE - "Besim A.Zejnullahu B.I- N.SH.EKO-DDD"-Ferizaj
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.